



Republika e Kosovës
Republika Kosovo-Republic of Kosovo
Kuvendi - Skupština – Assembly

Legjislatura V

Sesioni pranveror

Komisioni për të Drejtat e Njeriut, Barazi Gjinore, Persona të Pagjetur dhe Peticione
Mbledhja nr. 16

Prishtinë, më 22.05.2015, në orën 13:00

Ndërtesa e Kuvendit, salla N-302

PROCESVERBAL

I Komisionit për të Drejtat e Njeriut, Barazi Gjinore,
Persona të Pagjetur dhe Peticione

Në mbledhje morën pjesë: Lirije Kajtazi, kryetare, Salihe Mustafa, Slavko Simiq, Mexhide Mjaku-Topalli, Mytaher Haskuka, Teuta Haxhiu, Etem Arifi dhe Kujtim Paçaku.

Mungoi: Valdete Bajrami.

Stafi Mbështetës i Komisionit: Reshit Gashi, koordinator i Komisionit, Sulltane Gashi, zyrtare e fushës dhe Burim Tahiri, mbështetës i Komisionit, UNICEF.

Pjesëmarrës të tjerë: Salihe Salihu Abazi-Kuvendi i Kosovës, Sami Kurteshi-AP, Viola Durmishi-EU-Office, Felix Rathje-EU Office, Sakibe Jashari- Ambasada e Zvicrës, Visar Sutaj-KDI, Jeton Bytyçi-OSBE, Bekim Kodraliu-OSBE, Edona Tolaj- YIHR-KS, Basri Berisha-IAP dhe Arta Xhylani, praktikante në Kuvendin e Kosoves.

Mbledhjen e kryesoi, Lirije Kajtazi, kryetare e Komisionit.

Për këtë mbledhje u propozua ky

Rend i ditës:

- 1. Shqyrtimi i Projektligjeve në procedurë: Projektligji për Avokatin e Popullit, Projektligji për Barazi Gjinore, Projektligji për Mbrojtjen nga Diskriminimi.**

Kryetarja konstatoi se janë plotësuar kushtet për fillimin e punës dhe e hapi mbledhjen me pikën e rendit të ditës.

1. Miratimi i rendit të ditës;

Kryetarja konstatoi se rendi i ditës u miratua pa ndryshime.

Kryetarja tha se për këtë mbledhje kemi shqyrtimin e tri projektligjeve, të cilat janë shqyrtuar me procedurë të përshpejtuar dhe se grupet e punës i kanë shqyrtuar dhe propozimet e tyre do t'i paraqesin para komisionit.

Fillimisht fjala ju dha deputetes Teuta Haxhiu, për të referuar për Projektligjin për Mbrojtjen nga Diskriminimi.

Teuta Haxhiu prezantoi punën e grupit të punës për shqyrtimin e Projektligjit për Mbrojtjen nga diskriminimi dhe tha se grupi i punës dje ka mbajtur mbledhjen dhe ka shqyrtuar projektligjin nen për nen dhe para komisionit ka sjellë propozim-amendamentet.

Teuta Haxhiu tha se grupi i punës është që neni 9, të hiqet por këtë po e debatojmë edhe në komision.

Pas një debati në komision, u vendos që neni 9 të mbetet në Projektligj.

Ajo po ashtu tha se te neni 20, kemi propozuar rritjen e gjobave, dhe pas një debati në komision lidhur me këtë nen, komisioni miratoi edhe propozimin për rritjen e gjobave

U vendos që për paragrafin e parë të shkohet me këtë ndryshim.

Neni 23, paragrafi 1, numri „treqind (300)” hiqet dhe zëvendësohet me „katërqind (400), numri „pesëqind (500)” hiqet dhe zëvendësohet me numrin „gjashtëqind (600)”.

Ndërsa për paragrafët e tjerë të bëhet gjithkund rritja për 50%.

Komisioni shqyrtoi propozim- amendamentet e grupit të punës dhe miratoi si vijon:

Amendamenti 1,Me këtë amendament miratohen të gjitha përmirësimet gjuhësore, në tërë tekstin e Projektligjit, të cilat nuk e ndryshojnë, nuk e plotësojnë dhe nuk e modifikojnë përmbajtjen e Projektligjit dhe për të cilat nuk janë paraqitur amendamente të veçanta“.

Amendamenti 2,Neni 1, paragrafi 1. Në rreshtin e 8-të, hiqen fjalët „të përcaktuara me ligj apo marrëveshje dhe instrumente ndërkombëtare" dhe teksti vazhdon si në projektligj.

Amendamenti 3,Neni 4, paragrafi 1.9., Riformulohet si vijon: „**Diskriminimi në bazë të perceptimit -konsiderohet diskriminim sipas nenit 1 (një) të këtij Ligji, vendosja në objektiv jo të personave që i përkasin një grupi të caktuar, por personave të tretë që perceptohen se i përkasin grupit“.**

Amendamenti 4,Neni 9 paragrafi 1, fjalia e parë riformulohet si vijon: „**Avokati i Popullit është Institucion i shtetit, i cili bën promovimin dhe mbrojtjen e të drejtave të njeriut**”, fjalia e dytë mbetet si në projektligj.

Paragrafi 2.14. në rreshtin e 4-të, hiqen fjalët „nëse aprovohen nga Kuvendi“ dhe teksti vazhdon si në projektligj.

Amendamenti 5.Neni 14 paragrafi 3 riformulohet si vijon; „**Subjektet kanë mundësi të paraqesin padi për diskriminimin sipas këtij ligji, jo më vonë se 5 (pesë) vjet nga dita që i dëmtuari merr dijëni për këtë shkelje**“.

Paragrafi 4, në rreshtin e tretë, fjalia që fillon pas presjes, riformulohet si vijon: „**që mund të dëshmojë sjelljen diskriminuese përfshirë edhe të dhënat statistikore**“.

Amendamenti 6, Neni 16 paragrafi 1, hiqet fjalia e dytë që fillon në rreshtin e 6-të, pas pikës.

Amendamenti 7, Neni 20 paragrafi 1, në rreshtin e tretë fjala „fakte“ zëvendësohet me fjalën „prova“.

Amendamenti 8, Neni 23 paragrafi 1, numri „treqind (300)“ hiqet dhe zëvendësohet me „katërqind (400)“, numri „pesëqind (500)“ hiqet dhe zëvendësohet me numrin „gjashtëqind (600)“.

Paragrafi 2 , numri „shtatëqind (700)“ hiqet dhe zëvendësohet me numrin „njëmijë e pesëdhjetë (1050)“, numri „nëntëqind (900)“ hiqet dhe zëvendësohet me numrin „njëmijë e treqind e pesëdhjetë (1350).

Paragrafi 3, numri „pesëqind (500)“ hiqet dhe zëvendësohet me numrin „shtatëqind e pesëdhjetë“ dhe numrin „shtatëqind (700)“ hiqet dhe zëvendësohet me numrin „njëmijë e pesëdhjetë (1050).

Paragrafi 4, numri „treqind (300), hiqet dhe zëvendësohet me numrin „katërqind e pesëdhjetë (450)“, numri „pesëqind (500)“ hiqet dhe zëvendësohet me numrin „shtatëqind e pesëdhjetë (750).

Paragrafi 5, numri „shtatëqind (700), hiqet dhe zëvendësohet me numrin „njëmijë e pesëdhjetë (1050)“, numri „nëntëqind (900)“ hiqet dhe zëvendësohet me numrin „njëmijë e treqind e pesëdhjetë (1350)“.

Paragrafi 6 , numri „treqind (300), hiqet dhe zëvendësohet me numrin „katërqind e pesëdhjetë (450)“ numri „pesëqind (500)“ hiqet dhe zëvendësohet me numrin „shtatëqind e pesëdhjetë (750).

Paragrafi 7 , numri „treqind (300)“, hiqet dhe zëvendësohet me numrin „katërqind e pesëdhjetë (450)“ numri „pesëqind (500)“ hiqet dhe zëvendësohet me numrin „shtatëqind e pesëdhjetë (750).

Paragrafi 8 , numri „treqind (300), hiqet dhe zëvendësohet me numrin „katërqind e pesëdhjetë (450)“, numri „pesëqind (500)“, hiqet dhe zëvendësohet me numrin „shtatëqind e pesëdhjetë (750).

Amendamenti 9, Neni 26, fjalët „një (1) viti“ zëvendësohen me fjalët „6 (gjashtë) muaj“.

Shqyrtimi i Projektligji për Barazi Gjinore

Lirije Kajtazi, referuese e Grupit të punës për shqyrtimin e Projektligjit për Barazi Gjinore, tha se e kemi shqyrtuar këtë projektligj dhe kemi sjellur propozim-amendamentet para komisionit për shqyrtim të mëtejshëm:

Pas shqyrtimit të propozim- amendamenteve një nga një, komisioni vendosi të miratojë amendamente si vijon:

Amendamenti 1,Me këtë amendament miratohen të gjitha përmirësimet gjuhësore, në tërë tekstin e projektligjit, të cilat nuk e ndryshojnë, nuk e plotësojnë dhe nuk e modifikojnë përmbajtjen e projektligjit dhe për të cilat nuk janë paraqitur amendamente të veçanta”.

Amendamenti 2,Në tërë tekstin e projektligjit, fjalët „grave dhe burrave” zëvendësohen me fjalët „femrave dhe meshkujve”.

Amendamenti 3,Neni 3, paragrafi 1.1, riformulohet si vijon: „Barazia gjinore është ushtrimi i plotë dhe i barabartë i femrave dhe meshkujve, i të drejtave të tyre të njeriut. Është mosprania e diskriminimit në bazë gjinore, në mundësitë, ndarjen e burimeve apo përfitimeve, si dhe qasjen në shërbime”.

Neni 3, paragrafi 1.4, riformulohet si vijon: „Trajtimi i barabartë, pa kurrfarë diskriminimi të drejtpërdrejtë apo të tërthortë në bazë të gjinisë dhe promovimin e barazisë gjinore”.

Neni 3, paragrafi 1.15, në rreshtin e katërt shifra „40 %” zëvendësohet me shifrën „50 %” dhe ky ndryshim bëhet në tërë tekstin e projektligjit.

Neni 3, paragrafi 1.22, fjala “sterotipet” zëvendësohet me fjalën “stereotipet”.

Amendamenti 4,Neni 5, paragrafi 1.2, pas fjalës “miratimin e ” , shtohen fjalët “strategjive dhe” dhe teksti vazhdon si në projektligj.

Neni 5, paragrafi 1.3, fjala “futjen” zëvendësohet me fjalën “përfshirjen” dhe teksti vazhdon si në projektligj.

Amendament 5,Neni 7, në fund të fjalisë, pas kllapës, hiqet fjalia “apo në organin pasues që vendos Qeveria”.

Amendament 6,Neni 13, titulli riformulohet si vijon “Avokati i Popullit” .

Neni 13, në rreshtin e parë, fjala “organ” zëvendësohet me fjalën “institucion” dhe vazhdon teksti si në projektligj.

Amendament 7,Neni 16, paragrafi 2.11, në rreshtin e parë pas fjalës “ standardeve” shtohet fjala “të tjera” dhe vazhdon teksti si në projektligj.

Neni 16, paragrafi 2.11, në rreshtin e tretë, fjala “seksi” ” zëvendësohet me fjalën “gjini”.

Neni 16, paragrafi 2.11, në rreshtin e pestë, pas numrave në kllapa, shtohen fjalët “të këtij neni” dhe fjalia vazhdon si në projektligj.

Amendament 8,Neni 22, paragrafi 1, në rreshtin e katërt, fjala “fakte” zëvendësohet me fjalën “prova”.

Amendament 9, Neni 23, paragrafi 1 riformulohet si vijon: “ Për kundërvajtje nga nenet 2, 3 dhe 5 të këtij ligji, gjykata kompetente zhvillon procedurë kundërvajtëse dhe shqipton sanksione”.

Amendament 10,Neni 24, në rreshtin e tretë, fjalët “1 (një) viti”, zëvendësohen me fjalët “ 6 (gjashtë) muaj” dhe teksti vazhdon si në projektligj.

Shqyrtimi i Projektligjit për Avokatin e Popullit;

Mytaher Haskuka tha se grupi i punës ka shqyrtuar Projektligjin për Avokatin e Popullit edhe në prani të përfaqësuesve të Shoqërisë Civile dhe palëve të interesuara, dhe se kemi bërë propozim- amendamentet, të cilat do t'i shqyrtojmë edhe në komision. Ai para komisionit paraqiti propozim- amendamentet e grupit të punës si vijon:

Amendamenti 1

„Me këtë amendament miratohen të gjitha përmirësimet gjuhësore, në tërë tekstin e Projektligjit, të cilat nuk e ndryshojnë, nuk e plotësojnë dhe nuk e modifikojnë përmbajtjen e Projektligjit dhe për të cilat nuk janë paraqitur amendamente të veçanta“.

Amendamenti 2, Neni 5, paragrafi 1.2, ndryshohet dhe plotësohet si vijon: **” 5 (pesë) zëvendës të Avokatit të Popullit”.**

Salihe Mustafa propozoi që te neni 6, paragrafi 1.5, të jetë që „të mos ketë ushtruar funksion në parti politike 3 vitet e fundit” dhe pjesa tjetër të mbetet si është. Meqenëse është anëtare e këtij komisioni, tha se nuk ka paraqit amendament individual, dhe se këtë qëndrim do ta mbrojë edhe në Kuvendin e Kosovës.

Amendamenti 3, Neni 7, paragrafi 1, në rreshtin e dytë, fjala **”duhet”** zëvendësohet me fjalën **”mund”**.

Mexhide Mjaku Topalli- tha se te neni 8 paragrafi 8 kemi diskutuar shumë për këtë qështje, e kemi shqyrtuar edhe në shqyrtim të parë në komision, e kam paraqitur edhe në Kuvend këtë qështje, në grup punues u pajtuam dhe propozoj amendamentin 4 si ne vijim;

Amendament 4, Neni 8, paragrafi 8, ndryshohet dhe plotësohet si vijon: **”Lista e ngushtë përmban 3 (tre) kandidatë, përveç në rastin kur brenda numrit 3 (tre), ka më shumë kandidatët me pikë të barabarta vlerësuese. Paneli përzgjedhës listën e kandidatëve ia dorëzon Komisionit”.**

Amendamenti 5, Neni 9, paragrafi 3, në rreshtin e parë, hiqet numri **”3 (tre)”**.

Amendamenti 6, Neni 10, shtohet paragrafi i ri 1, si vijon: **”Zëvendësit e Avokatit të Popullit i zgjedh Kuvendi i Republikës së Kosovës, me shumicën e votave të deputetëve të pranishëm dhe që votojnë”.**

Paragrafi ekzistues 1, bëhet paragrafi 2 dhe kështu më radhë ndryshon renditja e paragrafëve.

Amendamenti 7, Neni 10, paragrafi ekzistues 2, ndryshohet dhe plotësohet si vijon: **”Avokati i Popullit, për zgjedhjen e 1 (një) zëvendësi, i propozon Kuvendit së paku 2 (dy) kandidatë.**

Amendamenti 8, Neni 13, pas paragrafit 2, shtohet paragrafi i ri 3, si vijon: **"Zëvendës Avokatin e Popullit e shkarkon Kuvendi, me votat e shumicës së të gjithë deputetëve të Kuvendit"**.

Paragrafi 3 bëhet paragrafi 4.

Amendamenti 9, Neni 16, paragrafët 8 dhe 9 bashkohen në një pragraf dhe pas fjalës së fundit të paragrafit ekzistues 9, vihet presje dhe shtohet fjalia **"përveç rastit kur ka zvarritje të procedurave"**.

Paragrafi ekzistues 10, bëhet paragrafi 9 dhe kështu me radhë.

Amendament 10, Neni 17, paragrafi 2.1, në fund të fjalisë, „pikëpresja” zëvendësohet me „presje” dhe shtohet teksti si vijon: **"duke përfshirë ndalimin policor, paraburgimin, qëndrimin në institucionet shëndetësore, ndalimin doganor, ndalimin e emigracionit dhe çdo vend tjetër kur dyshohet se ka shkelje të të drejtave dhe lirive të njeriut"**.

Amendamenti 11, Neni 17, paragrafi 4, në fjalinë e parafundit, para fjalës pajtimin shtohet fjala **"me"**.

Amendamenti 12, Neni 18, paragrafi 8, ndryshohet dhe plotësohet si vijon: **"Avokati i Popullit dhe përfaqësuesit e tij, sipas detyrës zyrtare, mund të hyjnë në të gjitha hapësirat zyrtare të të gjitha autoriteteve"**.

Amendament 13, Neni 25, pas paragrafit 2, shtohet paragrafi i ri 3, si vijon: **"Në rastin kur institucioni refuzon të bashkëpunojë ose ndërhyjë në procesin e hetimit, Avokati i Popullit ka të drejtë të kërkojë nga prokuroria kompetente fillimin e procedurës ligjore, për pengimin e kryrjes së detyrës zyrtare"**.

Amendament 14, Neni 32, paragrafit ekzistues i paravëhet numri rendor 1.

Pas paragrafit ekzistues, shtohet paragrafi i ri 2, si vijon: **"Personeli i Institucionit të Avokatit të Popullit zgjidhet në mesin e qytetarëve të Republikës së Kosovës, në një proces të hapur dhe transparent, bazuar në kriteret profesionale. Ndaj të punësuarve në IAP, zbatohen dispozitat e Ligjit për Shërbimin Civil, për atë që nuk cenohet pavarësia kushtetuese e Institucionit"**.

Amendamenti 15, Neni 34, paragrafi 1, ndryshohet dhe plotësohet si vijon : **"Paga e Avokatit të Popullit është ekuivalente me pagat e ministrave të Qeverisë së Kosovës dhe pagat e zëvendësve të Avokatit të Popullit janë ekuivalente me pagat e zëvendësministrave"**.

Komisioni në fund shqyrtoi edhe njëherë të gjitha amendamente e propozuara në Projektligjin për Avokatin e Popullit dhe vendosi që amendamenti i propozuar në nenin 6, paragrafi 1.5 nuk kalon, mbetet propozimi si në Projektligj, ndërsa amendamentet e tjera miratohen siç janë cekur më lart.

Kryetarja në fund falënderoi të gjithë për kontributin e dhënë në amendamentimin e këtyre projektligjeve.

Mbledhja përfundoi në orën 18:30.

E përgatiti: Njësia për Mbështetjen e Komisionit.

Kryetarja e Komisionit

Lirije Kajtazi